



TË DHËNAT PËR ASETIN

Shitja e Aseteve me Likuidim Nr. 34

Njësia nr. 63

Instruktori Hapësirë Afariste Podujevë

Emri i NSH.-së

NSH Auto Shkolla Instruktori ("Ndërmarrja")

Lloji i shitjes

Shitja me Likuidim me ofertë të mbyllur

Dita e Ofertimit

31.07.2017 në Sallën e Kuqe të Pallatit të Rinisë.

Regjistrimi i Ofertuesit

Deri më 24.07.2017 në Zyrën Qendrore të AKP-së.

Depozita e Ofertës

40,000 Euro

Vendndodhja e Aseteve

Podujevë

Përshkrimi i Aseteve

Ndërtesat dhe tokat

Instruktori Hapësirë Afariste Podujevë përfshinë hapësirën afariste me sipërfaqe prej 834 m² e cila gjendet në hyrje të Podujevës, në magjistralen Prishtinë-Podujevë, afër Hotel Besiana.

Pronësia e hapësirës afariste dëshmohet me Vendimin e themelimit të NSH-së, nr.04/46 të datës 24.12.1991. Në bazë të këtij vendimi, themeluesi Shoqata Auto Moto Mladost i jep NSH Instruktorit në shfrytëzim hapësirën afariste me sipërfaqe prej 834 m². Gjithashtu, ekziston edhe vendimi nr. 351-1319 i datës 24.12.1987 për aneks ndërtimin e lokalit për kontrollimin teknik që i është dhënë Shoqatës Auto Moto Mladost.

Njëra pjesë e hapësirës afariste, përfshinë zyra administrative, tualetet, dhomën e instalimit të ngrohjes qendrore. Kjo pjesë shtrihet në dy nivele (P+1). Ndërsa pjesa tjetër që përfshinë pasazhin, objektin për servisimin e automjeteve dhe objektin për kontrollim teknik shtrihet në një nivel - përdhes. Të gjitha pjesët janë të lidhura mes veti dhe ka qasje edhe nga hyrje të veçanta dhe përmes pasazhit.

Në kuadër të ndërtesës dy katëshe (P+1), përkatësisht në pjesën ballore të përdhes së objektit gjendet Ndërmarrja e Re Mekanizimi Podujevë e cila



Shfrytëzuesit

përfshinë sipërfaqen totale prej 120 m² (hapësira afariste + tualeti). Kjo pjesë është privatizuar në Valën 42 të Privatizimit dhe nuk është pjesë e njësisë **Instruktori Hapësirë Afariste Podujevë**.

Shënim: Investitorët duhet të jenë në dijeni se vetëm hapësira e njësisë **Instruktori Hapësirë Afariste Podujevë** e përshkruar më lartë do ti bartet blerësit të ri dhe asnjë pjesë tjetër e ndërtesës.

Në bazë të matjeve në teren, sipërfaqja e përgjithshme bruto e njësisë **Instruktori Hapësirë Afariste Podujevë** është përafërsisht 875.89 m².

Toka në të cilën gjendet objekti është në emër të Komunës së Podujevës dhe nuk është pjesë e **Instruktori Hapësirë Afariste Podujevë**.

Lokali nuk shfrytëzohet nga pala e tretë.

Përshkrimi i Aseteve

Asetet tjera

J/A

Detyrimet që do të barten

Nuk ka detyrime që do të transferohen tek pronari i ri, megjithatë blerësi duhet të ketë parasysh se tatimi mbi transferimin e pronësisë mund të zbatohet.

Foto/fotot
Ose informata të tjera
Për asetet në shitje

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATIZATION AGENCY OF KOSOVO

Njësia Instruktori Hapësirë Afariste Podujevë



Legjenda

- Instruktori Përdhese me sipërfaqe përafërsisht prej 532 m²
- Instruktori Kafi i me sipërfaqe të përafërt prej 327.4 m²
- Ndërmarrja e Re Mekanizimi Podujevë me sipërfaqe prej 120 m²

AKP - ZR Prishtinë
Data: 11.10.2016

Informatat

Departamenti i Shitjes – Njësia e Marketingut

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +381 (0) 38 500 400 ext 1255

Fax: +381 (0) 38 248 076

www.pak-ks.org

Dokumentet e Ofertimit

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Rruga: Agim Ramadani nr.23

10000 Prishtinë, Kosovë

Informatat që janë dhënë në këtë publikim mund të kenë pasaktësi, lëshime, ose gabime tipografike për të cilat Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk do të jetë në asnjë mënyrë përgjegjëse e as nuk do të pranojë përgjegjësi lidhur me përdorimin, vlefshmërinë, saktësinë, plotësinë ose besueshmërinë, pa marr parasysh natyrën e tyre. Investitorët e mundshëm inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) të kërkojnë dosjen elektronike dhe dokumentet për ofertim. Është në përgjegjësinë e secilit ofertues të mundshëm, që të bëjë hulumtimin paraprak në lidhje me NSH-në apo artikujt e tenderuar, me qëllim të mbledhjes së informatave të nevojshme. Këto të dhëna janë në dispozicion sipas kushteve të përgjithshme të cekura në Rregullat e Tenderit të cilat mund të merren nga faqja e AKP-së në internet: www.pak-ks.org